

Marreveshja per Pjesemarrjen ne Treg

nr. _____ date ____/____/____

Marreveshja per Pjesemarrje ne Tregun e Energjise Elektrike neshkruhet sot me date _____ midis Paleve :

- Operatorit te Sistemit te Transmetimit-Operatori i Tregut (OST-OT), i regjistruar ne Regjistrin Tregtar (Qendren Kombetare te Regjistrimit) me Vendimin nr. 31935 dt. 14/07/2004 dhe Seli ne _____, i perfaqesuar nga **Z. Engjëlli Zeqo**, ketu e me poshte i quajtur OST – OT.

- Pjesemarrresi ne Tregun e Energjise Elektrike, i regjistruar ne _____ me nr. _____ dhe Seli ne _____, i perfaqesuar nga _____, ketu e me poshte i quajtur _____

Kapitulli I Dispozita te Pergjithshme

Neni 1

- 1.1 OST sh.a. ne perputhje me Ligjin nr. 43/2015 "Per sektorin e energjise elektrike", neni 53, pika 1, eshte mbajtes i vetem i Licences per Transmetimin e Energjise Elektrike, te dhene nga ERE me Vendimin nr. 24 dt. 26/03/2009.
Ne baze te Rregullave te Tregut Shqiptar te Energjise Elektrike, Kapitulli II, pika 2.4, te miratuara me Vendimin nr. 139 dt. 25/08/2016 te Bordit te Komisionereve te ERE, nje nder funksionet e OST sh.a., eshte ai i Operatorit te Tregut.
- 1.2 (Pjesemarrresi i Tregut, Pale e kesaj kontrate) _____ ne perputhje me nenin 37, te Ligjit nr. 43/2015 "Per sektorin e energjise elektrike", eshte mbajtes i Licences per _____, te dhene nga ERE me Vendimin nr. ____dt.____/____/____.
Ne baze te Kapitulli II te Rregullave te Tregut Shqiptar te Energjise Elektrike, te miratuara me Vendimin nr. 139 dt. 25/08/2016 te Bordit te Komisionereve te ERE-s, (Pjesemarrresi i Tregut, Pale e kesaj kontrate) _____, ka funksionin e _____(sipas aktivitetit te licensuar) ne Tregun Shqiptar te Energjise Elektrike.

Kapitulli II

Qellimi i Marreveshjes

Neni 2

- 2.1 Kjo marreveshje rregullon marrëdhëniet ndërmjet paleve që e nënshkruajnë atë, OST-OT dhe Pjesëmarrësit në Tregun e Energjisë Elektrike dhe përcaktimin e detyrimeve dhe të drejtave që rrjedhin nga veprimtaria e tyre në tregun e energjisë.

Kapitulli III

Te drejtat dhe detyrimet e paleve

Neni 3

- 3.1 Palet, bien dakort të pranojnë rolin dhe funksionin përkatës të tyre në Tregun e Energjisë Elektrike, dhe angazhohen të zbatojnë me kujdesin e duhur ligjet, kodet, rregullat dhe praktikën tregtare që rregullojnë ose kanë të bëjnë me Sektorin e Energjisë Elektrike dhe Tregun e Energjisë Elektrike.
- 3.2 Palet, bien dakort të ndertojnë dhe zbatojnë marreveshje dhe kontrata me Pjesëmarrësit e Tregut të Energjisë Elektrike në përputhje me Rregullat e Tregut.
- 3.4. Palet, bien dakort të shkembejnë informacione dhe të dhëna në përputhje me të drejtat dhe detyrimet e tyre përkatëse për informim në përputhje me Rregullat e Tregut.
- 3.5. Palet marrin përsiper të përmbushin detyrimet financiare përkatëse në përputhje me Rregullat e Tregut dhe Marreveshjet dypalëshe të lidhura në përputhje me to. Në çdo rast Palet nuk do të ndermarrin kompensimin e ndërsjellte të detyrimeve pa rakordimin dhe miratimin e palës tjetër.

Kapitulli IV

Pjesëmarrësi në Treg

Neni 4

- 4.1 Pjesëmarrësi në treg bie dakort që t'u përmbahet në çdo kohë Rregullave të Tregut, gjithë kodeve teknike shoqërore, dhe procedurave të brendshme të OST – OT që nevojiten për funksionimin e Tregut të Energjisë Elektrike:
- 4.2 Te gjitha aktet e brendshme të OST – OT sipas pikës 4.1, të cilat Pjesëmarrësi do të duhet t'i zbatojë do të vendosin detyrime të cilat nuk i tejkalojnë detyrimet e përcaktuara në aktet ligjore dhe nenligjore në fushën e energjisë elektrike dhe në aktet e nxjerra nga ERE.

Neni 5

5.1 Pjesemarrësi në treg është i detyruar të informojë OST – OT në lidhje me çdo kontratë të lidhur. Ai duhet të dorëzojë në OST – OT informacion për çdo kontratë, duke identifikuar si më poshtë:

- i. Identifikimin e palëve të kontraktuara
- ii. Pikat e livrimit/tërheqjes
- iii. Kohëzgjatjen e kontratës
- iv. Sasitë e kontraktuara

Këto kërkesa do të zbatohen për gjithë kontratat dypalëshe, përfshirë kontratat për eksport/import.

5.2 Kontrata e lidhur ndërmjet dy pjesemarrësve në treg, bëhet efektive pasi OST – OT të ketë konfirmuar marrjen e saj. OST – OT duhet të konfirmojë marrjen e një kontrate të tillë brenda jo më vonë se 10 ditë pune. Mungesa e konfirmimit brenda këtij afati e bën efektive kontratën.

Neni 6

Pjesemarrësi në treg duhet të dorëzojë tek OST – OT njoftimet lidhur me gjithë shkëmbimet fizike neto mes palëve individuale (njoftime kontraktuale) ose ndërmjet palëve përgjese për balancimin, me qëllim realizimi fizik të detyrimeve kontraktuale.

Neni 7

7.1. Pjesëmarrësi në treg do t'i paraqesë OST një Program Ditor në përputhje me procesin e programimit të ditës në avancë siç specifikohet në Kodin e Rrjetit, me qëllim që OST të përcaktojë formatin e Programit Ditor.

7.2. Forma dhe menyra e paraqitjes së programit ditor dhe procedurat e tjera ndihmëse janë objekt i përcaktimit të OST sh.a në përputhje me Kodet e Rrjetit dhe Rregullat e tregut.

Neni 8

- 8.1 Pjesëmarrësi në treg do të marrë përgjegjësi për balancimin perkundrejt OST per gjithë prodhimin, blerjen, importin, eksportin, shitjen ose konsumin e tij.
- 8.2 Pjesëmarrësit e tregut të energjisë elektrike mund të rregullojnë përgjegjësinë për balancimin, nëpërmjet një kontrate me Operatorin e Sistemit të Transmetimit duke marrë statusin e palës përgjegjëse për balancim ose duke nënshkruar një kontratë për transferimin e përgjegjësisë së balancimit ndaj një pale tjetër përgjegjëse për balancimin, duke u bërë pjesëtar i një grupi balancues, në përputhje me rregullat e tregut. Në rast se kjo balance nuk ofrohet dhe për çdo mos realizim në kohë, substance dhe forme të detyrimeve që rrjedhin nga Rregullat e Tregut dhe kjo marrveshje, nga pala përgjegjëse, Pjesëmarrësi mund të kërkojë shpërblim.
- 8.3 Deri në krijimin e tregut të balancimit, tarifatat për realizimin e shërbimit të balancimit vendosen sipas metodologjisë së miratuar nga ERE. Kjo metodologji duhet të reflektojë kostot dhe bëhet publike.
- 8.4 Atje ku Rregullat e Tregut nuk e përcaktojnë përgjegjësinë do të nxirret në bazë të Kodit Civil.

Kapitulli V OST – OT

Neni 9

- 9.1 OST- OT, ka të drejtë të kërkojë nga pjesëmarrësi i tregut të gjithë informacionin e nevojshëm, në përputhje me Rregullat e Tregut të Energjisë Elektrike, Kodin e Rrjetit dhe Kodet Teknike shoqërore, procedurat dhe protokollet e brendshme të OST – OT që nevojiten për funksionimin e Tregut të Energjisë Elektrike.

Neni 10

- 10.1 OST - OT është e detyruar të përdorë informacionin e siguruar nga pjesëmarrësi i tregut, në përputhje me Rregullat e Tregut të Energjisë Elektrike, Kodin e Rrjetit dhe Kodet Teknike shoqërore, procedurat dhe protokollet e brendshme të OST – OT që nevojiten për funksionimin e Tregut të Energjisë Elektrike.

Neni 11

11.1 OST - OT do t'i bëjë të disponueshme çdo pjesëmarrësi në treg çdo informacion lidhur me operimin e tregut të energjisë elektrike të papërcaktuar si konfidencial ose komercialisht të ndjeshëm.

Perjashtimisht percaktimeve te 11.1, dhe vetem ne interesin dhe funksionin publik qe rrjedh nga veprimtaria e operatorit te sistemit te shperndarjes ("OSSH) dhe furnizuesi i sherbimit universal (FSHU)OST-OT do ti jape OSSH-se dhe FSHU-se te dhena qe keto operatore (d.m.th OSSH dheFSHU) dhe mund te kerkojne per mbarvajtjen e sherbimeve te tyre.

Kapitulli VI

Hyrja ne fuqi dhe Zgjidhja /Perfundimi i Marreveshjes

Neni 12

12.1 Nenshkrimi i kesaj marreveshje eshte kusht per pjesmarrje ne Tregun e Energjise Elektrike. Nenshkrimi do te behet vetem nga persona te cilet jane te autorizuar drejtperdrejte ne baze te legjislacionit shqiptar apo me prokure per te perfaqesuar secilen pale.

12.2 Kjo marreveshje behet efektive dhe e detyrueshme per Palet ne daten e zbatimit te saj.

12.3 Kjo marreveshje eshte pa afat dhe Pjesemarrresi mund ta zgjidh duke i dhene njoftim paraprak OST-OT. OST-OT nga ana e saj mund ta zgjidh marreveshjen vetem per arsye te mbeshtetura dhe vetem pas miratimit te ERE.

Neni 13

13.1 Një pjesëmarrës tregu mund të tërhiqet nga tregu i energjisë elektrike me iniciativën e tij, bazuar në një njoftim me shkrim të nënshkruar nga përfaqësuesi i autorizuar i këtij pjesëmarrësi. Njoftimi duhet paraqitur të paktën **3** muaj para datës kur duhet anuluar regjistrimi i pjesëmarrësit të tregut dhe duhet perfunduar marreveshja. Pas marrjes së këtij njoftimi, OST-ja do të informojë menjëherë të gjithë pjesëmarrësit e tjerë të tregut.

Neni 14

Nëse pjesëmarrësi nuk mund t'i plotësojë të gjitha kushtet e Rregullave të Tregut atëherë pjesëmarrësi ose OST-OT duhet të informojnë ERE-n brenda 10 ditë pune nga konstatimi për kushtet.

Neni 15

OST-OT do të pezulloje veprimtarinë tregtare të pjesëmarrësve nëse plotësohet ndonjë nga kushtet e mëposhtme:

- Pjesëmarrësi i tregut nuk përmbush më një ose më shumë kushte të nevojshme për regjistrim si pjesëmarrës tregu (siç përcaktohet në Dispozitat për Procedurat e Regjistrimit në Tregun e Energjise Elektrike)
- Pjesëmarrësi i tregut nuk përmbush më kërkesat që lidhen me garancinë financiare ose nuk bën pagesat e tjera (te parashikuara në Dispozitat për Procedurat e Regjistrimit në Tregun e Energjise Elektrike)
- Pjesëmarrësi i tregut nuk respekton Marrëveshjen për Pjesëmarrjen në Treg
- Pjesëmarrësi i tregut gjendet vazhdimisht fajtor për mosrespektimin e rregullave të tregut dhe gjithë kodeve të zbatueshme për tregun shqiptar të energjisë elektrike ose marrëveshjen financiare.

Neni 16

Nëse pjesëmarrësi i tregut nuk mund të provojë se e ka shmangur shkakun (Shkaqet) që shkaktoi pezullimin e tij, gjatë periudhës së specifikuar në njoftimin për pezullim, atëherë OST-OT do të procedojë me përfundimin e Marrëveshjes për Pjesëmarrjen në Treg.

Nëse ky vendim i OST-OT kundërshtohet nga pjesëmarrësi atëherë pas paraqitjes së ankesës, ERE-ja do të verifikojë nëse arsyet për pezullimin e veprimtarive tregtare janë të justifikuara dhe do ta japë vendimin brenda 15 ditëve punë nga marrja e ankesës.

Paraqitja në ERE e anekses nga Pjesëmarrësi i Tregut, pezullon zbatimin e vendimit të OST sh.a deri në marrjen e vendimit nga ERE.

Neni 17

Nëse regjistrimi i pjesëmarrësit të tregut pezullohet atëherë të gjitha ofertat e mbetura pezull (të reja) të pjesëmarrësit të tregut do të anulohen automatikisht për gjithë periudhën e pezullimit.

Neni 18

18.1 OST-OT do ta përfundojë Marrëveshjen për Pjesëmarrje në Treg të një pjesëmarrësi tregu në secilin nga këto raste:

- i. Nëse pjesëmarrësi në treg nuk përmbush më një ose disa nga kushtet e nevojshme për regjistrimin si pjesëmarrës tregu (siç përcaktohet në Dispozitat për Procedurat e Regjistrimit në Tregun e Energjise Elektrike)
- ii. Nëse pjesëmarrësi në treg nuk përmbush më kërkesat që lidhen me garancinë financiare, siç përcaktohet në Dispozitat për Procedurat e Regjistrimit në Tregun e Energjise Elektrike)
- iii. Nëse pjesëmarrësi i tregut nuk respekton Marrëveshjen për Pjesëmarrjen në Treg

- iv. Nëse pjesëmarrësi në treg gjendet vazhdimisht fajtor për mosrespektimin e rregullave të tregut dhe gjithë kodeve të zbatueshme për tregun shqiptar të energjisë elektrike

18.2 Marrëveshja për Pjesëmarrjen në Treg do të revokohet automatikisht dhe menjëherë, kur pjesëmarrësit në treg i hiqet licenca nga ERE-ja.

Neni 19

Mosmarrveshjet mes paleve që nuk janë arritur të zgjidhen në mënyrë miqësore do të lihen në kompetencën e ERE për t'u gjykuar. ERE do të japë vendimin e saj brenda 15 ditëve pune nga dita nga marrja e ankesës. Pavarësisht vendimit të ERE dhe pas arritjes së këtij vendimi, palët kanë të drejtë t'i drejtohen gjykates për shqyrtimin gjyqësor të konflikteve. Gjykata kompetente për shqyrtimin e mosmarrveshjeve do të jetë Gjykata Administrative

Kjo marrëveshje nënshkruhet në tre kopje, një për pjesëmarrësin në treg dhe dy për OST – OT.

Forma e kësaj marrëveshjeje është miratuar nga ERE si "Marrëveshja për Pjesëmarrjen në Treg", me vendimin nr. _____ date ____/____/____

Operatori i Sistemit të Transmetimit

Pjesëmarrësi në Treg
